



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHENDETESISE DHE MBROJTJES SOCIALE
QENDRA SHENDETSORE E SPECIALITETEVE NR.1
TIRANE

Nr. 163 Prot.

Tirane me, 10 .02.2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT 1
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Drejtuar: “ALBAPHOTO” shpk me NIPT- K86618008S.
Adresa” Rr. “Kole Idromeno” Nd. 89, H.3, Ap.30, Shkoder

Procedura e prokurimit: –“Proçedurë e hapur, e thjeshtuar” – Prokurim me mjete
Elektronike – Mallra

Numri i procedurës : **REF: 55988-01-16-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "**Blerje filma dixhitale per imazherine**"

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 7 Date 23.01.2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “ALBAPHOTO” shpk me NIPT- K86618008S

Vlera 1 550 000 (nje milion e peseqind e pesedhete mije) leke pa tvsh,

2. . “ISOMETRIC” shpk NIPT- L92207009A

Vlera 1 199 000 (nje milion e njeqind e nentedhete mije) leke pa tvsh.

3. “Aquarius Medical” shpk NIPT- L81512021D

Vlera: Operatori nuk ka paraqitur oferte ekonomike

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “ISOMETRIC” shpk NIPT- L92207009A

¹ Ky Formular eshte i aplikueshem nese ka Ankime

Pas verifikimeve rezulton se Operatori ekonomik Isometric shpk nuk ka paraqitur dokument te kerkuar nga Autoriteti Kontraktor Sipas Dokumentave Standarte te Tenderit si me poshte:

1.Sipas kriterëve të DST Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit të objektit të prokurimit të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Nga verifikimet rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur vetem fatura tatimore shitje, furnizime te cilat nuk perputhen me objektin e prokurimit.

Pra, operatori ekonomik nuk e verteton dhe nuk deshmon me faturat elektronike te ngarkuara ne sistemin e SPF-se , per furnizime te meparshme te ngjashme me objektin e prokurimit. Nuk ka furnizuar asnje ent publik apo sektor privat me filma dixhitale per imazherine, referuar faturave elektronike te paraqitur nga OE ne sistemin SPF-se.

2.Sipas kriterëve të DST-se, operatori ekonomik duhet të jete i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, **ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit**, dhe ka statusin aktiv;

Nga verifikimet ne Qenden Kombetare te Biznesit (QKB), ne ekstraktin e thjeshte dhe historik te shoqerise “Isometric” shpk nuk eshte e shprehur qarte ku te perkoje se objekti i veprimtarise te operatorit ekonomik eshte i njejte me objektin e prokurimit.

Persa me sipër si dhe referuar DST-se, me rastet e mosparaqitjes së dokumentave Operatori Ekonomik Isometric shpk ploteson kushtet për skulaifikim.

2. “Aquarius Medical” shpk NIPT- L81512021D

Pas verifikimeve si dhe referuar DST-se, me rastet e mosparaqitjes së dokumentave Operatori Ekonomik Aquarius Medical shpk ploteson kushtet për skulaifikim. Operatori nuk ka paraqitur oferte ekonomike dhe asnje dokument tjetër të kërkuar në DST.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “**ALBAPHOTO” shpk Adresa**” Rr. “Kole Idromeno” Nd. 89, H.3, Ap.30, Shkoder se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **1 550 000 (nje milion e peseqind e pesedhjetë mijë) leke pa tvsh /pikët totale të marra [_____]** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Qendres Shendetesore te Specialiteteve nr.1 , rruga Belul Hatibi, Tirane, tel :045620244**, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

ETLEVA BALLA